



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BANKA E SHQIPËRISË
GUVERNATORI

Nr. 4913 prot.

Tiranë, më 30.09.2019

VENDIM

Nr. 4913, datë 30.09.2019

**PËR
CAKTIMIN E SHITESËS KUNDËRCIKLIKE TË KAPITALIT**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 2, shkronja ‘b’; nenit 11, pikat 1 dhe 7; nenit 12, pika 3; nenit 14, pikat 5, 6, 7, 8 dhe 9; dhe nenit 16, pika 1, shkronja ‘a’, ‘ç’ dhe ‘d’, të rregullores ‘Për shtesat makroprudenciale të kapitalit’ miratuar me vendimin nr. 41, datë 5.6.2019 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë (më poshtë, ‘rregullorja 41/2019’), bazuar në propozimin e Departamentit të Stabilitetit Financiar,

VENDOSA:

1. Norma e shtesës kundërciklike të kapitalit (KUNC) për Shqipërinë është 0 (zero) për qind.
2. Bankat duhet të raportojnë shkallën e përmbushjes së shtesës kundërciklike të kapitalit sipas paragrafit 1 të këtij vendimi, duke filluar nga data 30 shtator 2020.
3. Ngarkohet Kabineti i Guvernatorit dhe Departamenti i Kërkimeve për publikimin e këtij vendimi në faqen e internetit dhe në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.
4. Ngarkohen Departamenti i Stabilitetit Financiar dhe Departamenti i Mbikëqyrjes me ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

GUVERNATOR

Gent Sejko